



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Froni 1" Sh.P.K. të datës 14.01.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i hapsirave Parkut gjelberues ne Bregun e Diellit" me nr. të prokurimit 616-24-13478-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Froni 1" Sh.P.K. të datës 14.01.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i hapsirave Parkut gjelberues ne Bregun e Diellit" me nr. të prokurimit 616-24-13478-1-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Froni 1" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 14.01.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i hapsirave Parkut gjelberues ne Bregun e Diellit" me nr. të prokurimit 616-24-13478-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Duke par Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1/9.2 të pikës 9, OE duhet të dëshmojë se ka në dispozicion pajisjet për realizimin e projektit.

- a) Kamion me vinq;
- b) Minieskavator 1.50- 5.50 ton;
- c) Kamionetë me peshë 2.00 – 3.50 ton;

Dëshmia : 9. Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë-pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmojnë me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre (të noterizuara) ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmojë edhe me kontratë e noterizuar mbi qeramarrjen, pasi që librezat mbi pronësinë e kompanis janë shumë thjesht për të verifikuar, pa pasur nevojë të noterizohen si kushtëzim nga AK. Nëse si OE kërkojmë për pajisjet me librezat që nuk kanë nevojë të noterizohen si kushtëzim nga AK. Andaj kërkojmë të behet rishqyrtimi dhe korrigjimi i këtyre kërkesave e që janë diskriminuese dhe favorizuese, në rast se nuk bëni korrigjimin nëse si OE do të dërgojmë Ankesën në OSHP-të.

Lidhur me pretendimet ankimore është gjetur se noterizimi i kopjes së librezave të qarkullimit për pajisjet e kërkuara me DT është kërkesë e panevojshme dhe nuk është aspak kërkesë e domosdoshme. Së këndejmi vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik". Prandaj AK duhet të korrigjoj dosjen e tenderit ashtu që të largoj pjesën e kërkesës ku thuhet që librezat e qarkullimit të mjeteve duhet të dorëzohen si kopje të noterizuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 21.01.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.